




ГРАДЕЊЕ НА УСЛУГИ ZASNOVANI NA ZAEДНИЦАТА
ЗА ПОДДРШКА NA PECOИЈАЛИЗАЦИЈА И
РЕИНТЕГРАЦИЈА NA ПОРАНЕШНО ОСУДЕНИ ЛИЦА

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT TË PROBACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2021-2025)

Periudha e monitorimit:
viti 2023



Наслов на оригиналот:

МОНИТОРИНГ НА СПРОВЕДУВАЊЕ НА СТРАТЕГИЈАТА НА РАЗВОЈ НА ПРОБАЦИСКА СЛУЖБА ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА (2021-2025)

Период на следење: 2023 година

Преведено од македонски на албански јазик:

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT TË PROBACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2021 – 2025)

Periudha e monitorimit: viti 2023

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Përfaqësuar nga:

Prof. Dr. Neda Zdraveva

Redaktore:

Uraniја Pirovska

Autore:

Aleksandra Trajanovska

Përkthimi në shqip:

Shenasi Jaji

Lektore:

Suzana V. Spasovska

Viti i botimit:

2024

Vendi i botimit:

Shkup

Numri i faqeve:

32

Dizajni grafik:

Masiva Creative Agency

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

354.51.075.5:343.24/.26:005.21(497.7)"2023"(047.31)

343.24/.26(497.7)"2023"(047.31)

TRAJANOVSKA, Aleksandra

Monitorimi i zbatimit të strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut [Електронски извор] : (2021-2025) : periudha e monitorimit: viti 2023 / [autore Aleksandra Trajanovska ; преведено од македонски на албански јазик пërkthimi në shqip Shenasi Jaji]. - Shkup : Komiteti i helsinkit për të drejtat e njeriut, 2024

Начин на пристапување (URL):

<https://mhc.org.mk/sq/publicationsanalyzes-sq/monitorimi-i-zbatimit-te-strategjise-per-zhvillimin-e-sherbimit-te-probacionit-ne-republiken-e-maqedonise-se-veriut-2021-2025-3/>.

- Превод на делото: Мониторинг на спроведување на стратегијата на развој

на пробациска служба во Република Северна Македонија : (2021-2025) : период на следење: 2023 година. - Текст во ПДФ формат, содржи 32 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 10.09.2024. - Библиографија: стр. 30. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-4977-27-8

а) Пробациска служба -- Стратегија за развој, 2021-2025 -- Спроведување -- 2023 -- Истражувања б) Алтернативни санкции и мерки -- Правна и институционална рамка -- Македонија -- 2023 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 64523781



МЗМП



Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e MZMP dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA	5
HYRJE	6
RRETH PROJEKTIT	8
METHODOLOGJIA	10
GJETJET NGA MONITORIMI	13
Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative	13
Rezultati 1.1. Analiza mbi nevojën për ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative	13
Rezultati 1.2. Ndryshimet në kornizën ligjore për të rritur numrin e sanksioneve dhe masave alternative të shqiptuara	13
Rezultati 1.2.1. Të zgjerohet zbatueshmëria e punës së dobishme në komunitet në Kodin Penal	14
Rezultati 1.2.2. Përdorimi më i madh i sanksioneve alternative në Ligjin e Procedurës Penale	14
Rezultati 1.2.3. Të zgjatet periudha nën mbikëqyrje dhe mbështetja për personat në lirim me kusht nga ana e shërbimit të probacionit	14
Rezultati 1.3. Ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit	14
Rezultati 1.4. Aktet nënligjore të plota dhe të përditësuara për zbatimin praktik të sanksioneve alternative dhe funksionimin e shërbimit të probacionit	15
Rezultati 1.5. Analiza e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore dhe procedurat e punës për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative në rastet e drejtësisë për personat e mitur	15
Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit – zyrat funksionale	16
Rezultati 2.1. Në funksion janë 15 zyra probacioni dhe mbulojnë çështjet e probacionit për rajonet e të gjitha gjykatave	16
Rezultati 2.2. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave standarde të punës në shërbimin e probacionit	16
Rezultati 3.1. Rritja e numrit të profesionistëve të punësuar në sektorin e probacionit në nivel qendror dhe vendor	16
Rezultati 3.2. Krijimi i një qendre trajnimi dhe një buxheti për trajnimin e shërbimit të probacionit dhe për bashkëpunim me qendrat dhe akademitë e tjera përkatëse të trajnimit	17

Rezultati 3.3. Zhvillimi i një plani vjetor trajnimi për oficerët e probacionit që përditësohet rregullisht.....	17
Rezultati 3.4. Trajnimet e rregullta bazë do të zhvillohen për të gjithë oficerët e probacionit	18
Rezultati 3.5. Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve speciale për lloje të veçanta klientësh	18
Rezultati 3.6. Trajtime të përbashkëta për krijimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit të institucioneve përkatëse	18
Rezultati 3.7. Trajnimi i trajnuesve.....	18
Veprimi – Përmirësimi i procedurës dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative	19
Rezultati 1.2.4. Të rritet numri i sanksioneve alternative dhe të zvogëlohet numri i sanksioneve alternative të ankimuara	19
Rezultati 4.3. Rritja e numrit të aktgjykimeve për punë të dobishme në komunitet	19
Bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit.....	24
Rezultati 5.2. Mbajtja e tryezave të rregullta në nivel qendror dhe në të gjitha fushat me përfaqësues të autoriteteve gjyqësore dhe partnerët nga rrjeti i bashkëpunëtorëve	24
Rezultati 5.3. Protokollet e bashkëpunimit dhe listat e partnerëve të bashkëpunimit janë krijuar dhe përditësohen rregullisht	24
Rezultati 5.4. Përgatitja e mëtutjeshme e memorandumeve për bashkëpunim me komunat dhe ndërmarrjet tjera publike për kryerjen e punëve së dobishme në komunitet.....	24
Rezultati 5.5. Organizimi i tryezave të rregullta të shërbimit të probacionit dhe shërbimit të burgjeve në të gjitha fushat, në kuadër të institucioneve penitenciare dhe përcaktimi i procedurave standarde të punës për bashkëpunim me institucionet e vuajtjes së dënimit	25
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	26
LITERATURA E PËRDORUR	30
Shtojca 1 – Matrica e monitorimit	31

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

KP – KODI PENAL

LPP – LIGJI I PROCEDURËS PENALE

RMV – REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

DES – DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE

KGjRMV – KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

PPRMV – PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

OSHC – ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

REKA – REGJISTRI ELEKTRONIK KOMBËTAR I AKTEVE TË RMV-së

PSO – PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

HYRJE

Shërbimi i probacionit (provës) është një njësi e veçantë organizative e krijuar në kuadër të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë. Shërbimi mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve pa burg (pa privim nga liria), më konkretisht masat alternative: dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, punë në dobi të përgjithshme dhe arrest shtëpie, si dhe ekzekutimin e lirimit me kusht, të shqiptuar me vendim gjykate. Shërbimi i probacionit mbikëqyr personat e dënuar dhe u ofron atyre mbështetje, kurse synimi është ruajtja e sigurisë në komunitet duke përmirësuar risocializimin dhe riintegrimin e personave në probacion, si dhe reduktimin e numrit të personave të burgosur. Gjithashtu, shërbimi i probacionit është përgjegjës për përgatitjen e raporteve për vlerësimin e rezultatit të personave të akuzuar gjatë procedurave gjyqësore me propozim për llojin e sanksionit penal për të akuzuarin. Shërbimi i probacionit është një pjesë thelbësore e sistemit modern të drejtësisë penale dhe synon të kontribuojë në uljen e mbipopullimit në sistemin e burgjeve, duke dhënë njëkohësisht dënimet e duhura për shkelësit, duke bërë që ata të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës.

Në vitin 2021 është përgatitur Strategjia për Zhvillimin e Shërbimit të Probacionit në RMV 2021-2025 (në tekstin e mëtejme: Strategjia), e cila parasheh një gamë të gjerë rezultatesh që duhet të arrijnë disa institucione kompetente. Strategjia është një dokument strategjik gjithëpërfshirës që ofron një udhërrëfyes për reformat që do të bëhen në periudhën e ardhshme.

Qëllimi i kësaj analize është të shqyrtojë në mënyrë më të detajuar zbatimin e Strategjisë dhe të krijojë dhe zbatojë një sistem monitorimi të pavarur. Vetë probacioni (prova), në fakt nënkupton vendosjen e një sistemi efikas të sanksioneve dhe mekanizmave mbrojtës që kontribuojnë në uljen e kriminalitetit, rritjen e mbrojtjes së shoqërisë dhe sigurisë publike, si dhe në risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar.

Në periudhën gjatë vitit 2023, zbatimi i Strategjisë parashikon hartimin dhe miratimin e rregulloreve (ligje, ndryshime ligjore dhe akte të tjera), zbatimin e aktiviteteve specifike (p.sh. rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të shërbimit të probacionit, etj.), si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit (mbajtjen e tryezave të rrumbullakëta me institucionet përkatëse, takime tremujore, etj.).

Me Planin e veprimit të Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përcaktohen aktivitetet në kuadër të secilit qëllim dhe rezultat të përcaktuar me Strategjinë, si dhe përcaktohen afatet kohore dhe indikatorët për përbushjen e tyre. Në këtë drejtim, qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë nëse, në çfarë mase dhe në çfarë mënyre po bëhet zbatimi i Strategjisë për periudhën për të cilën është paraparë. Gjithashtu, analiza do të vlerësojë nëse rezultatet dhe aktivitetet janë realizuar në kohën e duhur, në përputhje me afatin kohor, cila është cilësia e tyre dhe dinamika dhe bashkëpunimi ndërinstytucional në fushën e probacionit. Nga ana tjetër, do të analizohet ndikimi i reformave në respektimin e të drejtave të njeriut, kështu që në përputhje me rezultatet e nxjerra nga monitorimi i Strategjisë, Analiza do të ofrojë edhe konkluzione dhe rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit të probacionit.

Vëzhgimi, si sistem i pavarur i monitorimit, do të kontribuojë në një llogaridhënie më të madhe të institucioneve kompetente që janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve specifike të përcaktuara në këtë Strategji.

RRETH PROJEKTIT

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Ngritja e shërbimeve në komunitet për mbështetje nëpërmjet risocializimit dhe riintegrit të ish-personave të dënuar”, financuar nga Bashkimi Evropian. Për qëllime të projektit, është lidhur memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, Shoqatës Penologjike Maqedonase, Shoqatës për këshillim, trajtim, riintegrim dhe risocializim të personave të varur nga substancat psikoaktive IZBOR dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të zvogëlojë recidivizmin dhe cenueshmërinë e personave të dënuar pas lirit të tyre, duke forcuar politikat dhe shërbimet për risocializimin, riintegrimin dhe kujdesin pas-penal të tyre në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe evropiane.

Qëllimet specifike të cilat synon projekti:

- Të përmirësojë cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve për mbrojtje penale dhe post-penale me qëllim të risocializimit dhe riintegrit të personave të dënuar, të dënuar më parë, si dhe personave që kryejnë punë probacioni;
- Të rritet kapaciteti dhe bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet institucioneve penale, gjykatave, nëpunësve të probacionit, qendrave për punë sociale dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve për risocializim, probacion dhe mbrojtje post-penale;
- Të përmirësohet korniza ligjore dhe politikat për risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar, të dënuar më parë, si dhe të personave që i nënshtrohen dënimit me kusht bazuar në hulumtimet dhe praktikatat më të mira.

Objektivat e projektit do të arrihen nëpërmjet një grupi të ndërlidhur prej tre komponentësh: **Ofrimi i shërbimit** që përfshin aktivitete për krijimin e një shërbimi kombëtar mbështetës për risocializimin dhe rehabilitimin e të burgosurve në partneritet midis OSHC-ve dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve (DES), bashkëpunim që do të sigurojë mbështetje para dhe pas lirit nga burgu (mbështetje juridike, psikosociale, trajtimi i karrierës dhe i varësisë). Nëpërmjet këtij komponenti, projekti do të pilotojë një program për lehtësimin e punësimit të ish-personave të burgosur, në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit dhe sektorin e biznesit.

Komponenti **Ngritja e Kapaciteteve dhe Rrjetëzimi** parashikon zhvillimin e kurrikulës dhe materialeve të trajnimit, zbatimin e një programi trajnimit për gjyqtarët, këshilltarët e burgjeve, nëpunësit e probacionit, punonjësit socialë dhe ofruesit e shërbimeve, organizimin e seminareve rajonale për të përcaktuar kushtet për bashkëpunim ndërinstitucional dhe krijimin dhe sigurimin e mbështetjes së tre ekipeve vendore ndërinstitucionale për mbështetjen e koordinuar pas-penale. Monitorimi i zhvillimit të shërbimit të probacionit në RMV 2021 – 2025 është pjesë e komponentit të tretë **Korniza për Hulumtim dhe Politika**, i cili do të mbështesë gjithashtu hartimin e dy procedurave operative standarde (POS), organizimin e konferencave dhe hartimin e dokumenteve të politikave.

METODOLOGJIA

Qëllimi i kësaj analize është të shqyrtojë më në detaje zbatimin e Strategjisë dhe të krijojë dhe zbatojë një sistem të pavarur monitorimi. Po ashtu, në atë drejtim, analiza do të vlerësojë nëse, në çfarë mase dhe në çfarë mënyre po bëhet zbatimi i Strategjisë për periudhën për të cilën është paraparë. Do të vlerësohet nëse rezultatet dhe aktivitetet janë realizuar në kohën e duhur, në përputhje me afatin kohor, cila është cilësia dhe dinamika e tyre dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit. Nga ana tjetër do të analizohet ndikimi i reformave në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në përputhje me rezultatet e nxjerra nga monitorimi i Strategjisë do të nxirren konkluzionet kryesore se çfarë është zbatuar dhe çfarë ka munguar, dhe cilat janë pengesat kryesore për të, madje do të ofrohen rekomandime për zbatimin e mëtejshëm të Strategjisë.

Fokusi i monitorimit janë katër tema, përkatësisht:

- Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative;
- Korniza institucionale – Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit – zyrat funksionale;
- Veprimi – Përmirësimi i veprimit dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative;
- Bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit.

Brenda këtyre katër elementeve, sipas një matrice të paracaktuar monitorimi (shtojca 1), subjekt i monitorimit do të jenë:

- Vlerësimi i zbatimit të rezultateve;
- Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve;
- Vlerësimi i dinamikës së zbatimit të aktiviteteve specifike;
- Vlerësimi i nivelit të përfshirjes së aktorëve kryesorë;
- Vlerësimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së aktiviteteve të zbatuara;
- Vlerësimi i ndikimit mbi të drejtat e njeriut për secilin aktivitet.

Monitorimi, si sistem i pavarur i monitorimit, do të kontribuojë në një llogaridhënie më të madhe të institucioneve kompetente që janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve specifike të përcaktuara në Strategji. Gjithashtu, monitorimi do të vlerësojë realizimin e rezultateve të pritshme të përcaktuara në Strategji dhe realizimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit në lidhje me katër temat që janë objekt i monitorimit.

Monitorimi do të realizohet përmes nën-aktiviteteve të mëposhtme:

1. Mbledhja e të dhënave

Të dhënat do të mblidhen në disa mënyra, nëpërmjet:

- shqyrtimit dhe analizës së dokumenteve, strategjive, ligjeve, akteve nënligjore, raporteve nga fusha e probacionit;
- kërkesave për akses të lirë në informacione të natyrës publike pranë institucioneve përkatëse (Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, zyrat e probacionit, gjykatat);
- intervistave gjysmë të strukturuar dhe grupeve të synuara me nëpunësit e probacionit, gjyqtarët dhe personat në probacion, Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve, si dhe institucione të tjera përkatëse.

2. Raportimi dhe publikimi

Si rezultat i monitorimit, do të përgatiten dhe publikohen gjashtë raporte, me një pasqyrë të gjetjeve kryesore të procesit të monitorimit. Nga raportet do të bëhen edhe infografikë, në mënyrë që të prezantohen më lehtë të gjeturat nga monitorimi.

3. Promovimi i gjetjeve

Raportet do të ndahen me institucionet përkatëse dhe do të jenë të disponueshme publikisht në faqen e internetit të partnerëve të projektit.

4. Diskutim mbi gjetjet

Gjetjet e secilit raport do t'u prezantohen palëve kryesore të interesit në një tryezë të rumbullakët. Çdo institucion do të ftohet të japë komente mbi gjetjet e raportit. Ngjarjet do të sigurojnë që të gjitha institucionet përkatëse të ndërgjegjësohen për shkallën e zbatimit të strategjisë, si dhe për problemet që mund të ndikojnë në zbatimin e reformave në sektorin e probacionit.

5.

Reagimi/Avokimi

Si përjashtim, nëse identifikohen gjetje të caktuara specifike që kërkojnë veprime urgjente dhe të menjëhershme, do të përgatiten njoftime për të gjitha institucionet përkatëse dhe do të ndërmerren aktivitete avokuese për të përcaktuar problemet.

Raporti i parë do të analizojë rezultatet dhe aktivitetet në lidhje me katër temat, d.m.th atë që ishte planifikuar të zbatohet gjatë vitit 2023. Plani i Veprimit i Strategjisë për Zhvillimin e Shërbimit të Probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përcakton aktivitetet në kuadër të çdo qëllimi dhe rezultati të përcaktuar nga Strategjia, si dhe një kornizë kohore dhe tregues që Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për Ekzekutimi e Sanksioneve, zyrat e Shërbimit të Probacionit dhe autoritetet e tjera gjyqësore duhej t'i zbatonin në vitin 2023.

Ky është raporti i dytë në serinë e raporteve. Raportet e mëpasshme do të përgatiten sipas kësaj metodologjie monitorimi. Nëse është e nevojshme, çdo raport mund të përfshijë një seksion që lidhet me situatën aktuale me shërbimin e probacionit.

GJETJET NGA MONITORIMI

Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative

Rezultati 1.1. Analizë e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore për mbështetjen e shërbimit të probacionit dhe sanksioneve alternative

Ky rezultat i Strategjisë¹ u përmbush në periudhën 2021-2022, kur grupi i punës analizoi nevojat e ndryshimeve në kornizën ligjore për mbështetjen e shërbimit të probacionit dhe sanksioneve alternative në kuadër të projektit “Mbështetja e BE-së për shtetin e së drejtës” pas mbajtjes së katër tryezave të rrumbullakta me temë “Analiza e nevojave të ndryshimit të kornizës ligjore”, për të cilat bëri një raport. Shërbimi i probacionit u ka bërë propozime grupeve punuese që punojnë për ndryshime në Kodin Penal dhe Ligjin për Procedurë Penale dhe është e nevojshme që të miratohen ndryshimet në ligjet sistemike dhe më pas të harmonizohet Ligji për Probacionin me to.

Rezultati 1.2. Ndryshimet në kornizën ligjore për rritjen e numrit të sanksioneve dhe masave alternative të shqiptuara

Në pjesën e zhvillimit të kornizës ligjore në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative, Strategjia parasheh ndryshime dhe plotësime në Ligjin Penal dhe Ligjin për Procedurën Penale. Këto ndryshime do të bazohen në analizat e bëra nga grupi i punës i krijuar dhe listën e propozimeve nga projekti Twinning “Forcimi i sistemit penitenciar dhe zhvillimi i shërbimit të probacionit”, i cili u zbatua në periudhën 2018-2020 nga DES. Kjo listë i referohet rezultateve të dhëna në vazhdim të tekstit (Rezultati 1.2.1; Rezultati 1.2.2; Rezultati 1.2.3).

¹ Strategjia për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021 – 2025).

Rezultati 1.2.2. Përdorimi më i madh i sanksioneve alternative në Ligjin e Procedurës Penale

Ndryshimet dhe harmonizimi i Ligjit për Procedurën Penale me Kodin Penal janë gjithashtu pjesë e rezultateve të parapara me Strategjinë me qëllim të harmonizimit të dy ligjeve në fushën e përdorimit të sanksioneve dhe masave alternative. Gjatë vitit 2023, këto ndryshime ligjore ende nuk janë miratuar.

Rezultati 1.2.3. Zgjatja e periudhës nën mbikëqyrje dhe mbështetja për personat me lirim me kusht nga shërbimi i probacionit

Praktika tregon se në shumicën e rasteve afati kohor prej 3 muajsh është shumë i shkurtër që shërbimi i probacionit të mund të ofrojë mbështetje dhe mbikëqyrje efektive ndaj personave të liruar me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Për këtë qëllim, Strategjia parashikon ndryshime në Kodin Penal të cilat do të parashikojnë një periudhë më të gjatë të mbështetjes dhe mbikëqyrjes së shërbimit të probacionit, me qëllim uljen e rrezikut të recidivizmit dhe zbatimin e mbështetjes efektive për risocializimin e suksesshëm të personave të dënuar. Ky rezultat në periudhën e monitorimit të Strategjisë ende nuk është përmbushur plotësisht.

Rezultati 1.3. Ndryshime në kornizën ligjore për mbështetjen e shërbimit të probacionit

Në vitin 2023 ishin paraparë ndryshime dhe plotësime në Ligjin për probacionin, por procesi ende nuk ka filluar për faktin se pritet që fillimisht të miratohen ndryshimet në Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve dhe më pas të kalohet në amendamente. Ligjit për probacionin, i cili do të forcojë pozitën e nëpunësve të probacionit dhe do të zgjerohet fusha e përdorimit të shërbimit të probacionit në procedurën penale dhe ekzekutimin e sanksioneve.

Rezultati 1.4. Akte nënligjore të plota dhe të përditësuara për zbatimin praktik të sanksioneve alternative dhe funksionimin e shërbimit të probacionit

Ky rezultat i paraparë në Strategji do të fillojë të zbatohet kur të bëhen ndryshimet e parapara ligjore në Ligjin për probacion.

Rezultati 1.5. Analizë e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore dhe procedurat e punës për mbështetjen e shërbimit të probacionit dhe sanksioneve alternative në rastet e drejtësisë për të miturit

Shërbimi i probacionit, sipas Ligjit të probacionit, punon vetëm me autorë të moshës madhore të krimeve. Strategjia parashikon një analizë të zgjerimit të mundshëm të kompetencave të shërbimit dhe të drejtësisë për të miturit, por këto aktivitete janë shtyrë për të forcuar së pari pozitën e shërbimit të probacionit në sistemin penitenciar. Për një analizë të suksesshme të nevojave për ndryshimin e kornizës ligjore dhe procedurave të punës për të mbështetur dënimin me kusht dhe sanksionet alternative për të miturit, duhet të përfshihen edhe organizatat ndërkombëtare që punojnë për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe sundimin e ligjit. Prandaj, duam të theksojmë se ky rezultat i Strategjisë nuk është përmbushur në periudhën e monitorimit, respektivisht gjatë vitit 2023.

Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit – zyrat funksionale

Rezultati 2.1. Në funksion janë 15 zyra probacioni dhe mbulojnë rastet e probacionit për rajonet e të gjitha gjykatave

Shërbimi i probacionit numëron 11 zyra funksionale të probacionit që janë themeluar në vitin 2022. Gjatë vitit 2023 nuk do të ketë hapje të zyrave të mbetura që parashikohen nga Strategjia për zhvillimin e shërbimit të probacionit. Ajo që mund të theksojmë si domethënëse është se në nivel vjetor mund të shohim një rritje të rasteve të probacionit, pra për vitin 2023 ky numër ishte 483 lëndë probacioni, kurse në vitin 2022 numri ishte 375 raste probacioni.

Rezultati 2.2. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave standarde të punës në shërbimin e probacionit

Duke qenë se nuk kanë filluar ende ndryshimet në Ligjin për probacion, përmbushja e këtij rezultati të Strategjisë nuk është realizuar. Për t'iu qasur zhvillimit të procedurave standarde të punës, është e nevojshme që fillimisht të hyjnë në fuqi ndryshimet në Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve dhe Ligjin për probacion.

Rezultati 3.1. Rritja e numrit të profesionistëve të punësuar në sektorin e probacionit në nivel qendror dhe vendor

Në përputhje me metodologjinë e punësimit, shërbimi i probacionit duhet të ketë gjithsej 90 nëpunës probacioni të cilët do të punësohen në periudhën 2021-2025. Megjithatë, ky numër nuk ka ndryshuar, kështu që në vitin 2023 shërbimi i probacionit numëron 28 nëpunës probacioni.

ZYRA E PROBACIONIT	BASHKËPUNËTORË TË RINJ	BASHKËPUNËTORË TË LARTË	KËSHILLTARË	ARKIVIST I PROBACIONIT	UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT PËR MBIKËQYRJE MBI KRYERJEN E PUNËVE TË PROBACIONIT
Sektori për probacion në DES	1	1	/	/	1
Shkup	4	1	3	1	/
Kumanovë	2	/	1	/	/
Manastir	2	/	/	/	/
Strumicë	/	1	/	/	/
Shtip	2	/	/	/	/
Ohër	1	/	/	/	/
Veles	1	/	/	/	/
Prilep	2	/	/	/	/
Kavadar	1	/	/	/	/
Gjevgjeli	/	/	/	/	/
Tetovë	3	/	/	/	/
GJITHSEJ	19	3	4	1	1

* Në zyrën e probacionit në Gjevgjeli nuk ka asnjë punonjës të punësuar dhe zyra e probacionit nga Strumicë i trajton rastet në atë zonë.

Rezultati 3.2. Themelimi i një qendre trajnimi dhe një buxhet për trajnimin e shërbimit të probacionit dhe për bashkëpunim me qendrat dhe akademitë e tjera përkatëse të trajnimit

Qendra e trajnimit të DES-it është krijuar dhe është vënë në dispozicion për realizimin e trajnimeve për punonjësit e sistemit penitenciar, ndër të cilët është edhe shërbimi i probacionit. Aktivitetet për emërimin e punonjësve në qendrën e shërbimit të probacionit, si dhe përgatitja e një plani të posaçëm buxhetor për qendrën e trajnimit, gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë, nuk janë realizuar ende.

Rezultati 3.3. Hartimi i një plani vjetor trajnimi për nëpunësit e probacionit, i cili përditësohet rregullisht

Për të forcuar kapacitetet dhe aftësitë e nëpunësve të probacionit, Strategjia parashikon përgatitjen e një plani trajnimi vjetor nga ana e DES. Në periudhën e monitorimit gjatë vitit 2023, u formua një grup pune për rishikimin e Strategjisë së trajnimit dhe përgatitjen e një

plani vjetor trajnimi për punonjësit në sistemin penitenciar së bashku me një plan veprimi që mbulon (punonjësit e DES, përfshirë shërbimin e probacionit si dhe punonjësit nëpër burgje.

Rezultati 3.4. Trajnime të rregullta bazë që do të zhvillohen për të gjithë nëpunësit e probacionit

Strategjia parasheh mbajtjen e trajnimeve bazë dhe speciale për nëpunësit e probacionit. Nga gjithsej 28 nëpunës probacioni, në vitin 2023, 12 nëpunës probacioni që janë pjesë e grupit të punës për marrëdhëniet me publikun kanë kaluar trajnimin bazë të komunikimit.

Rezultati 3.5. Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve speciale për lloje specifike klientësh

Në vitin 2023, të gjithë nëpunësit e probacionit kaluan një trajnim dy-ditor për të punuar me shkelësit e dhunshëm. Këto trajnime janë mbajtur nga ekspertë nga Kroacia të punësuar përmes projektit IPA “Mbështetje e BE-së për sundimin e ligjit, dhe qëllimi ka qenë që të forcohen kapacitetet e nëpunësve të probacionit për të punuar me lloje të veçanta të veprave penale që kërkojnë trajtim të ndryshëm.

Rezultati 3.6. Trajnime të përbashkëta për krijimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit të institucioneve përkatëse

Forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e njohurive është paraparë me mbajtjen e trajnimeve të përbashkëta me institucionet përkatëse. Në këtë drejtim, zyra e probacionit gjatë vitit 2023 dhe në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit për ofrimin e mbrojtjes penale dhe postpenale të personave të dënuar, të dënuar më parë dhe personave ndaj të cilëve kryhet punë probacioni me SHMJR-në, Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Shoqatën Izbor (Zgjedhja) mbajtën takimet fillestare me përfaqësues të shërbimit të probacionit, burgjeve dhe qendrave të punës sociale.

Rezultati 3.7. Trajnimi i trajnuesve

Gjatë vitit 2023, 7 nëpunës probacioni iu nënshtruan një trajnimi pesëditor për trajnues me ekspertë amerikanë të angazhuar me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Maqedoninë e Veriut. Qëllimi i këtyre trajnimeve është ndërtimi i një ekipi multidisiplinar trajnuesish i cili do të mbulonte të gjitha aspektet ligjore, psikologjike dhe sociale.

Veprimi/Trajtimi – Përmirësimi i veprimit/trajtimit dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative

Rezultati 1.2.4. Të rritet numri i sanksioneve alternative dhe të zvogëlohet numri i sanksioneve alternative të ankimuara

Probacioni si e ardhmja e sistemit të burgjeve parasheh që dënimi me burg të jetë zgjidhja e fundit dhe në vend të tij përdoren sanksionet dhe masat alternative të disponueshme me qëllim riintegrimin dhe risocializimin e personave të dënuar.

Në këtë drejtim, Strategjia parasheh sjelljen e rekomandimeve nga Këshilli Gjyqësor i RMV-së që do të nxisin dhe promovonin shqiptimin e më shumë dënimeve alternative me qëllim të reduktimit të mbipopullimit nëpër burgje, si dhe mbajtjen e tryezave të rrumbullakëta me gjyqtarë dhe prokurorë penalë për të promovuar shqiptimin e dënimeve alternative, veçanërisht të punës së dobishme në komunitet. Strategjia parasheh edhe miratimin e Udhëzimeve nga Prokurori Publik i RMV-së për të shmangur ankesat e panevojshme dhe joproductive, të cilat do të shfrytëzojnë masat dhe procedurat alternative dhe do të promovojnë dënime alternative. Gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë, KGJRMV-ja nuk ka nxjerrë rekomandime që do të nxisnin dënime dhe sanksione alternative, kurse as PPRMV-ja nuk ka nxjerrë udhëzimet e parashikuara.

Rezultati 4.3. Rritja e numrit të aktgjykimeve me punë të dobishme në komunitet

Shërbimi në komunitet është një sanksion alternativ i dëshirueshëm ndaj drejtësisë penale moderne që synon të reduktojë mbipopullimin në popullatën e burgjeve, si dhe të kontribuojë në risocializimin dhe rehabilitimin e shkelësve përmes orëve të papaguara të shërbimit në komunitet.

Strategjia parashikon rritje të numrit të aktgjykimeve për punë të dobishme në komunitet, si dhe promovimin e saj përmes tryezave të rrumbullakëta në të gjitha rajonet, me pjesëmarrjen e palëve përkatëse të interesit (gjyqtarët, prokurorët, Akademia e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë) dhe takime me kryetarët e gjykatave, KGJRMV dhe PPRMV. Gjithashtu, Strategjia parashikon lidhjen e një numri më të madh memorandumesh bashkëpunimi për kryerjen e shërbimit komunitar në zonat ku ka zyra probacioni.

Gjatë periudhës së monitorimit të Strategjisë në vitin 2023, shërbimi i probacionit nuk ka lidhur kontrata të reja me bashkitë dhe ndërmarrjet publike për kryerjen e punës së dobishme publike.

Në tekstin e mëposhtëm jepet një pasqyrë e detajuar e numrit të aktgjykimeve të shqiptuara me masa alternative (shërbim në komunitet, dënim me kusht, dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, paralajmërim gjyqësor dhe arrest shtëpiak) për vitin 2023, si dhe numrin e aktgjykimeve të ankimuara me masa të shqiptuara alternative nga gjykatat themelore në RMV.

Nga kjo pasqyrë vërehet se numri i aktgjykimeve të shqiptuara me masa alternative është i lartë për vitin 2023, respektivisht 4507 aktgjykime të shqiptuara. Kur bëhet fjalë për shqiptimin e dënimeve për punë të dobishme në komunitet, numri është relativisht i ulët, pra i parëndësishëm në raport me numrin e dënimeve me kusht. Numri i përgjithshëm i aktgjykimeve për punë në dobi të përgjithshme për vitin 2023 është 5 aktgjykime sipas të dhënave të marra nga gjykatat themelore në Maqedoninë e Veriut.

Numri i aktgjykimeve me dënim me kusht tregon mundësinë e një dënimi më të lartë të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, pasi autorët e krimeve nuk do të përjashtoheshin parimisht nga sanksionet, por do të merrnin ndihmë, kujdes, mbikëqyrje ose mbrojtje nga shërbimi i probacionit në përputhje me veprën e kryer.

Ligji parashikon shqiptimin e dënimit dhe paralajmërimit gjyqësor si sanksion alternativ për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me burg deri në një vit ose gjobë dhe që janë kryer në rrethana të tilla lehtësuese që i bëjnë ato veçanërisht të lehta.² Nga të dhënat statistikore, vërehet se shifra për vitin 2023 është 75 paralajmërime gjyqësore, (shërbimi i probacionit nuk është kompetent në rastin e paralajmërimeve gjyqësore).

Numri i aktgjykimeve të shqiptuara me arrest shtëpiak është pothuajse inekzistent, pra ai numër në vitin 2023 ka qenë 2 aktgjykime, (sipas të dhënave statistikore shërbimi i probacionit deri më tani nuk ka kryer mbikëqyrje të arrestit shtëpiak). Arsyeja pse aktgjykimi me arrest shtëpie është në nivel shumë të ulët është fakti se nuk është krijuar sistemi i mbikëqyrjes elektronike, si dhe mungesa e pajisjeve funksionale të mbikëqyrjes elektronike.

² Kodi Penal – Tekst i konsoliduar („Gazeta Zartare e RM-së“ nr. 55, viti 2013).

Nga të dhënat statistikore të marra nga Gjykatat Themelore të RMV-së, vërehet se në praktikë, aktgjykimet me masa dhe sanksione alternative të shqiptuara ende ankimohen në një numër relativisht të madh (në vitin 2023 janë ankimuar 880 aktgjykime).

Gjithashtu, jepet një prezantim i detajuar i numrit të rasteve të probacionit për vitin 2023, të ndara sipas llojit të masave të shqiptuara të probacionit. Numri i rasteve të probacionit po rritet çdo vit, respektivisht në vitin 2023 numri ishte 483 raste/lëndë probacioni. Sa i përket llojit të masave të shqiptuara të probacionit, shqetësues është numri i rasteve me punë të dobishme në komunitet, i cili për vitin 2023 shkon në 14 raste. Numri i rasteve të probacionit me dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse është rritur, pra është 175 krahasuar me vitin 2022 kur numri ishte 99 raste.

Krahasimi i të dhënave statistikore të marra nga gjykatat themelore në RMV për numrin e aktgjykimeve me masa alternative (shërbim në komunitet, dënim me kusht, dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, paralajmërim gjyqësor dhe arrest shtëpiak) dhe të dhënat statistikore të marra nga Sektori i probacionit për numrin e rasteve/lëndëve të probacionit, ka një ndryshim në numrin e përgjithshëm të rasteve. Për shembull, numri i rasteve të probacionit me punë të dobishme në komunitet për vitin 2023 është 14 raste, ndërsa numri i aktgjykimeve për punë të dobishme në komunitet është 5 raste.

Aktgjykime me sanksione të shqiptuara alternative në vitin 2023

GJYKATA THEMELORE	PUNA E DOBISHME NË KOMUNITET	DËNIM ME KUSHT	DËNIMI ME KUSHT ME MBIKËQYRJE MBROJTËSE	VËREJTJE GJYQËSORE	BURG SHTËPIAK	GJITHSEJ	TË ANKIMUARA
Gjykata Themelore Kumanovë	0	313	2	2	0	317	57
Gjykata Themelore Koçanë	0	143	0	1	0	144	33
Gjykata Themelore Shtip	0	172	0	5	1	178	11
Gjykata Themelore Kërçovë	0	152	0	0	0	152	9
Gjykata Themelore Prilep	0	228	3	9	0	240	42
Gjykata Themelore Tetovë	0	276	6	0	1	283	89
Gjykata Themelore Gostivar	0	217	0	5	0	222	51
Gjykata Themelore Radovish	0	0	0	0	0	0	0
Gjykata Themelore Veles	2	148	10	3	0	163	45
Gjykata Themelore Shën Nikollë	0	64	0	1	0	65	9
Gjykata Themelore Kavadar	0	133	0	0	0	133	29
Gjykata Themelore Manastir	0	334	2	244	0	580	115
Gjykata Themelore Dibër	0	37	0	0	0	37	2
Gjykata Themelore Dellçevë	0	25	0	1	0	25	7
Gjykata Themelore Resnjë	0	41	0	0	0	41	9
Gjykata Themelore Berovë	0	28	0	0	0	28	2
Gjykata Themelore Kratovo	0	10	0	1	0	11	3
Gjykata Themelore Kriva Pallankë	0	81	0	0	0	81	4
Gjykata Themelore Krushevë	0	13	0	0	0	13	1
Gjykata Themelore Gjevgjeli	0	134	0	1	0	135	7
Gjykata Themelore Negotinë	0	0	66	0	0	66	17
Gjykata Themelore Strugë	0	56	2	26	0	84	24
Gjykata Themelore Strumicë	0	198	0	5	0	203	24
Gjykata Themelore Ohër	0	166	1	1	0	168	32
Gjykata Themelore Viniçë	0	19	2	1	0	22	1
Gjykata Penale Shkup	3	923	176	14	0	1116	257
GJITHSEJ	5	3911	270	319	2	4507	880

Numri i rasteve/lëndëve të probacionit në vitin 2023 sipas llojit të masës së shqiptuar të probacionit

ZYRA LOKALE E PROBACIONIT	VLERËSIMI I RREZIKUT GJATË PROCESIT GJYQËSOR	DËNIMI ME KUSHT ME MBIKËQYRJE MBROJTËSE	PUNË E DOBISHME NË KOMUNITET	MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE TË LIRUAR ME KUSHT	GJITHSEJ
Shkup	87	139	12	72	310
Manastir	2	1	0	25	28
Tetovë	0	6	0	33	39
Shtip	1	0	1	17	19
Veles	0	5	1	11	17
Kumanovë	0	3	0	12	15
Prilep	0	0	0	9	9
Ohër	0	1	0	4	5
Strumicë	0	1	0	24	25
Gjevgjeli	0	0	0	5	5
Kavadar	0	1	0	10	11
GJITHSEJ	90	157	14	222	483

Bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit

Rezultati 5.2. Organizimi i tryezave të rregullta në nivel qendror dhe në të gjitha rajonet me përfaqësues të autoriteteve gjyqësore dhe partnerë nga rrjeti i bashkëpunëtorëve

Për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit të probacionit, bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore është i një rëndësie thelbësore, ndaj në këtë drejtim Strategjia parashikon mbajtjen e rregullt të tryezave të rrumbullakëta me të gjithë aktorët përkatës nga sistemi i drejtësisë, si dhe me partnerë nga rrjeti i bashkëpunëtorëve. (komunat, qendrat për punë sociale, agjencitë e punësimit, organizatat joqeveritare, etj.).

Në periudhën gjatë vitit 2023, përmes projektit IPA “Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit”, janë mbajtur 4 tryeza të rrumbullakëta me temën “Aplikimi më i madh i masave alternative” në katër rajonet e apelit në Shkup, Shtip, Gostivar dhe Manastir, të gjitha me qëllimin e avancimit dhe promovimit të shërbimit të probacionit dhe motivimi i gjyqtarëve për të shqiptuar më shumë masa alternative. Tryezat e rrumbullakëta u drejtuan nga ekspertë nga Kroacia së bashku me gjyqtarë nga Gjykata Penale e Shkupit me qëllim që të ndajnë përvojën e tyre në zbatimin e masave alternative në punën e tyre si një instrument i rëndësishëm për të reduktuar mbipopullimin nëpër burgje.

Rezultati 5.3. Protokolle bashkëpunimi dhe listë partnerësh për bashkëpunim, që do të përditësohen rregullisht

Rrjetëzimi i shërbimit të probacionit është thelbësor për menaxhimin e mirë të rasteve të probacionit, ndaj në këtë drejtim është i nevojshëm përditësimi i rregullt i protokolleve të bashkëpunimit, si dhe i listës së partnerëve. Lidhur me këtë rezultat të Strategjisë, gjatë periudhës së monitorimit nuk është zbatuar asnjë aktivitet shtesë. Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve mban shënime për të gjitha memorandumet e lidhura të bashkëpunimit, por ato nuk janë të disponueshme publikisht në faqen e internetit të DES.

Rezultati 5.4. Përgatitja e mëtutjeshme e memorandumeve për bashkëpunim me komunat dhe ndërmarrjet tjera publike për kryerjen e punës së dobishme në komunitet

Me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të punës së shërbimit të probacionit, Strategjia parashikon hartimin dhe nënshkrimin e memorandumeve të reja me partnerë të tjerë (komuna, ndërmarrje publike) për kryerjen e punës së dobishme në komunitet.

Gjatë periudhës së monitorimit, Drejtoria ka lidhur dy marrëveshje të reja bashkëpunimi me organizatat HOPS Opsione për Jetë të Shëndetshme dhe Stacioni PET, Prilep.

Rezultati 5.5. Organizimi i tryezave të rregullta të shërbimit të probacionit dhe shërbimit të burgjeve në të gjitha fushat, në kuadër të sistemit penitenciar dhe përcaktimi i procedurave standarde të punës për bashkëpunim me institucionet e vuajtjes së dënimit

Në lidhje me këtë rezultat, në maj të vitit 2023, u formua një grup pune i ngarkuar me hartimin e Protokollit Standard Operacional për përgatitjen për lirim dhe ndihmën pas-penale të personave të dënuar. Grupi punues përfshin përfaqësues nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, në punës të probacionit, sektorët për risocializim në burgje, si dhe përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Qendrat për Punë Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Drejtësia penale moderne synon të reduktojë mbipopullimin e popullsisë së burgjeve, si dhe të kontribuojë në risocializimin dhe rehabilitimin e autorëve të krimeve. Për të arritur këtë rezultat, nevojitet zhvillimi i vazhdueshëm i shërbimit të probacionit, i cili përfaqëson të ardhmen e sistemit të burgjeve.

Në përgjithësi, zhvillimi i shërbimit të probacionit është pjesë e një strategjie më të gjerë për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë në Maqedoninë e Veriut, duke kontribuar në përpjekjet e vendit drejt integritetit në Bashkimin Evropian dhe përmirësimin e parimit të sundimit të ligjit.

Gjetjet nga ky monitorim i Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021- 2025) për periudhën e vitit 2023 tregojnë se si po zhvillohet zbatimi i rezultateve dhe aktiviteteve të parapara në Strategji, d.m.th. nëse ato po zbatohen në kohën e duhur në përputhje me afatin kohor, cila është cilësia dhe dinamika e tyre dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e probacionit. Nga ana tjetër, analiza tregon mangësitë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jep udhëzime dhe rekomandime të qarta për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

Megjithëse nuk ka një mekanizëm të përsosur për zgjidhjen e situatës me mbipopullimin e të burgosurve, e cila është në një nivel shqetësues, Strategjia përfaqëson një pikënisje të mirë që mund të kontribuojë në reformimin e përgjithshëm të sistemit penal në tërësi dhe në reduktimin e mbipopullimit të burgjeve.

Ajo që mund të konkludojmë është se është e nevojshme që të gjithë aktorët përkatës (Ministria e Drejtësisë, Qeveria, gjyqtarët, prokurorët publikë, policia gjyqësore, nëpunësit e probacionit, oficerët e burgjeve, etj.) të jenë veçanërisht të përkushtuar, të ndershëm dhe të përgjegjshëm kur bëhet fjalë për përmbushjen e synimeve të rezultateteve të strategjisë, sepse zhvillimi i mëtejshëm i shërbimit të probacionit mund të kontribuojë në uljen e mbipopullimit në sistemin e burgjeve, duke shqiptuar njëkohësisht dënime të përshtatshme për shkelësit e ligjit, duke i bërë ata të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës. Përveç në Gjykatën penale themelore në Shkup, është e nevojshme të forcohen dhe inkurajohen gjyqtarët nga qytetet tjera të vendit që të fillojnë me shqiptim më të madh të aktgjykimeve me masa alternative që deri më tani kanë rezultuar të suksesshme në praktikë për risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar.

Qëllimet dhe aktivitetet e parashikuara në Strategjinë për zhvillimin e shërbimit të probacionit do të vazhdojnë të zbatohen me ritme të shtuara me ndihmën dhe mbështetjen e projektit të ri IPA, “Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit”, i cili do të zbatohet deri në vitin 2026.

Bazuar në rezultatet e fituara nga analiza e Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit (2021 – 2025), janë dhënë rekomandimet e mëposhtme për avancimin dhe zhvillimin e Shërbimit të probacionit, të ndara sipas temave.

Legjislacioni – Korniza ligjore në fushën e ekzekutimit të sanksioneve dhe masave alternative

- Miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve, Kodin Penal, Ligjin për Procedurën Penale dhe Ligjin për Probacion.
- Ndryshime ligjore të Kodit Penal në nenin 59a, që do të mbulojnë të gjithë personat me masën alternative të arrestit në shtëpi, në vend vetëm të grave të sëmura, të moshuara dhe shtatzëna.
- Fillimi i procesit të ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore
- Përgatitja e një analize të nevojave për ndryshime në kornizën ligjore dhe procedurat e punës për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative në rastet me drejtësinë për të miturit dhe përfshirjen e organizatave ndërkombëtare në RMV që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve, sundimi i ligjit, sistemi penitenciar etj. për përgatitjen e analizave për shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative në çështjet e drejtësisë për personat e mitur.

Korniza institucionale për funksionimin e shërbimit të probacionit – zyrat funksionale

- Hapja e zyrave të mbetura të probacionit (Gostivar, Koçanë, Kërçovë dhe Strugë).
- Rritja e buxhetit të shërbimit të probacionit për të punësuarit e rinj.
- Përgatitja e një plani të posaçëm buxhetor për qendrën e trajnimit.
- Përgatitja e rregullt e planeve vjetore të trajnimit për punonjësit e sistemit penitenciar (punonjësit e DES, përfshirë shërbimin e probacionit, si dhe punonjësit e burgjeve).

- Të vazhdohet me trajnimin e rregullt të nëpunësve të probacionit (kontrolli i emocioneve, intervista motivuese, modelimi prosocial, teknikat e intervistimit, teknikat e komunikimit, etj.).
- Rritja e numrit të trajnimeve të posaçme të zhvilluara (autorë të dhunës në familje, radikalizimit, punës me të varur nga droga dhe varësive të tjera si alkooli, bixhozi, kleptomania etj.).

Veprimi – Përmirësimi i veprimit dhe rritja e numrit të masave dhe sanksioneve alternative

- Miratimi i rekomandimeve nga Këshilli Gjyqësor i RMV-së që do të nxisin dhe promovojnë shqiptimin e dënimeve alternative.
- Nxjerrja e udhëzimeve nga Prokurori Publik i RMV-së për shmangien e ankesave të panevojshme dhe joproduktive, të cilat do të shfrytëzojnë masat dhe procedurat alternative.
- Prokuroria Publike të parashtojë propozim aktakuza për caktimin e masës alternative.
- Gjykatat të shqiptojnë më shumë dënime me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, në mënyrë që shkelësit të marrin ndihmë, kujdes, mbikëqyrje ose mbrojtje nga shërbimi i probacionit, në vend të vetëm një dënimi me kusht.
- Kohëzgjatja e lirimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse duhet të jetë më e gjatë se mesatarja e tre muajve për të arritur ndryshime reale të shkelësit të ligjit.
- Të unifikohet mbajtja e të dhënave statistikore për numrin e aktgjykimeve të shqiptuara me masa alternative dhe numrin e lëndëve të probacionit nga gjykatat themelore dhe shërbimi i probacionit.

Bashkëpunimi ndërinstytucional në fushën e probacionit

- Të rritet numri i memorandumeve të reja të lidhura për bashkëpunim me komunat dhe ndërmarrjet tjera publike për kryerjen e punëve të dobishme në komunitet.
- Përfshirja e një numri më të madh të organizatave të shoqërisë civile që do të ofrojnë programe të specializuara për autorët e krimeve (autorë të dhunës në familje, radikalizimit, punës me të varur nga droga dhe varësive të tjera si alkooli, bixhozi, kleptomania etj.).
- Programe të specializuara për autorët e veprave penale të organizatave të shoqërisë civile të jenë më të gjata në vend të 3 muajve, në mënyrë që të arrihen ndryshime reale të shkelësit të ligjit.
- Përditësimi i rregullt i listës së memorandumeve të nënshkuara dhe publikimi i tyre në faqen e DES-it.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet shërbimit të probacionit dhe burgjeve, i cili është thelbësor për të menaxhuar mirë kalimin e shkelësve nga kushtet e burgut në komunitet dhe shoqëri.
- Formimi i një komisioni të burgjeve (ekip multisektorial) që do të punojë rregullisht me të burgosurit që do të lirohen me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, në mënyrë që të bëhen plane individuale të punës në kohën e duhur për çdo person të dënuar.

LITERATURA E PËRDORUR

1. Strategjia për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021 – 2025).
2. Kodi Penal- Teksti i konsoliduar (përfundimisht me "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 55, 2013).
3. Ligji për procedurën penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150, datë 18.11.2010).
4. Projekt plani i veprimit të Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021 – 2025).

Shtojca 1 – Matrica e monitorimit

LEGJISLACIONI KORNIZA LIGJORE NË FUSHËN E EKZEKUTIMIT TË SANKSIONEVE DHE MASAVE ALTERNATIVE	2021	2022	2023	2024	2025
Rezultati 1.1. Analiza mbi nevojën për ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksione alternative					
Rezultati 1.2. Ndryshimet në kornizën ligjore për të rritur numrin e sanksioneve dhe masave alternative të shqiptuara					
Rezultati 1.2.1. Të zgjerohet zbatueshmëria e punës së dobishme në komunitet në Kodin Penal					
Rezultati 1.2.2. Përdorimi më i madh i sanksioneve alternative në Ligjin e Procedurës Penale					
Rezultati 1.2.3. Të zgjatet periudha nën mbikëqyrje dhe mbështetja për personat në lirim me kusht nga ana e shërbimit të probacionit					
Rezultati 1.3. Ndryshime në kornizën ligjore për të mbështetur shërbimin e probacionit					
Rezultati 1.4. Aktet nënligjore të plota dhe të përditësuara për zbatimin praktik të sanksioneve alternative dhe funksionimin e shërbimit të probacionit					
Rezultati 1.5. Analiza e nevojave për ndryshime në kornizën ligjore dhe procedurat e punës për të mbështetur shërbimin e probacionit dhe sanksionet alternative në rastet e drejtësisë për personat e mitur					
KORNIZA INSTITUCIONALE KORNIZA INSTITUCIONALE PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PROBACIONIT – ZYRAT FUNKSIONALE					
Rezultati 2.1. Në funksion janë 15 zyra probacioni dhe mbulojnë çështjet e probacionit për rajonet e të gjitha gjykatave					
Rezultati 2.2. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave standarde të punës në shërbimin e probacionit					
Rezultati 3.1. Rritja e numrit të profesionistëve të punësuar në sektorin e probacionit në nivel qendror dhe vendor					
Rezultati 3.2. Krijimi i një qendre trajnimi dhe një buxheti për trajnimin e shërbimit të probacionit dhe për bashkëpunim me qendrat dhe akademitë e tjera përkatëse të trajnimit					
Rezultati 3.3. Zhvillimi i një plani vjetor trajnimi për oficerët e probacionit që përditësohet rregullisht					

Rezultati 3.4. Trajnimet e rregullta bazë do të zhvillohen për të gjithë oficerët e probacionit					
Rezultati 3.5. Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve speciale për lloje të veçanta klientësh					
Rezultati 3.6. Trajnimet të përbashkëta për krijimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit të institucioneve përkatëse					
Rezultati 3.7. Trajnimi i trajnuesve					
VEPRIMI PËRMIRËSIMI I PROCEDURËS DHE RITJA E NUMRIT TË MASAVE DHE SANKSIONEVE ALTERNATIVE					
Rezultati 1.2.4. Të rritet numri i sanksioneve alternative dhe të zvogëlohet numri i sanksioneve alternative të ankimura					
Rezultati 4.3. Rritja e numrit të aktgjyqimeve për punë të dobishme në komunitet					
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL NË FUSHËN E PROBACIONIT					
Rezultati 5.2. Mbajtja e tryezave të rregullta në nivel qendror dhe në të gjitha fushat me përfaqësues të autoriteteve gjyqësore dhe partnerët nga rrjeti i bashkëpunëtorëve					
Rezultati 5.3. Protokollet e bashkëpunimit dhe listat e partnerëve të bashkëpunimit janë krijuar dhe përditësohen rregullisht					
Rezultati 5.4. Përgatitja e mëtutjeshme e memorandumeve për bashkëpunim me komunitat dhe ndërmarrjet tjera publike për kryerjen e punëve së dobishme në komunitet					
Rezultati 5.5. Organizimi i tryezave të rregullta të shërbimit të probacionit dhe shërbimit të burgjeve në të gjitha fushat, në kuadër të institucioneve penitenciare dhe përcaktimi i procedurave standarde të punës për bashkëpunim me institucionet e vuajtjes së dënimit					

*Përmbushja e rezultateve të parashikuara janë shënuar me ngjyrat e mëposhtme:

- ngjyrë të **kuqe** nëse rezultati nuk është përmbushur
- ngjyrë të **verdhë** nëse rezultati është përmbushur pjesërisht
- ngjyrë **jeshile** nëse rezultati është përmbushur (përmbushet rregullisht)
- ngjyra **portokalli** nuk është e aplikueshme për periudhën e monitorimit.

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMIT TË PROBACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2021-2025)

Periudha e monitorimit:
viti 2023

